

Joachim Röhm

Falënderim me rast të marrjes së çmimit "Jusuf Vrioni" për vitin 2010

E falëndëroj shumë jurinë që më ka nderuar me çmimin "Jusuf Vrioni" për vitin 2010. Ky vendim është me të vërtetë një nder i madh për mua, por edhe një inkurajim për të vazhduar punën time si përkthyes i letërsisë shqiptare me të gjitha forcat e mia.

Tashmë, afër pragut të pleqërisë, mund të konstatoj se kam kaluar gjysmën e jetës sime me shqiptarët. Bile kam krijuar krushqi me ta, pasi nuset e të dy djemve të mi janë shqiptare. Jam marrë me të gjitha aspektet e jetës shqiptare, por sidomos me kulturën, dhe në radhë të parë me letërsinë. Besoj se elementi përcaktues për pozitën e një populli në kujtesën e njerëzimit nuk janë peripecitë politike ose zhvillimet ekonomike, por trashëgimi kulturor.

Sot, pasi kam përkthyer disa mijëra faqe nga të gjitha gjinitë e letërsisë shqipe, besoj se kam të drejtë të them se zanati i përkthimit letrar është shumë më i vështirë sesa mendohet shpesh.

(Në parentezë dua të shtoj se sipas shumë gjasave është akoma më e vështirë të pozicionosh veprën e përkthyer në tregun e librit të botës perëndimore, sepse në atë botë është pikërisht tregu që vendos për fatin e saj. Por ky problem, me sa duket mua, u përket kryesisht botuesve shqiptarë që duhet të krijojnë marrëdhënie të rregullta dhe të ngushta me kolegët e tyre jashtë vendit, për të promovuar autorët e tyre.)

Por të kthehemi te problemet e profesionit tim. Nganjëherë më është dukur gati e pamundur të sjellë veprën letrare me kompleksitetin e tij ideor dhe stilistik, me shtresimet dhe mbishtresimet, nëntekstet, konotacionet etj. në gjuhën time amtare, aq më shumë se gjatë kësaj procedure duhet të kapërcehet edhe kufiri i rrezikshëm midis hapësirave kulturore dhe politike. Dhe në mbarim të punës u çudita vetë kur mundimet e mia kishin dalë (pak a shumë) mbarë. Sekret, sipas mendimit tim, është që përkthyesi duhet të kapë logjikën e brëndshme, siç e quaj unë, ose me fjalë të tjera: shpirtin e veprës.

Gëteja ynë i madh, në romanin e tij Vilhelm Majster, ka thënë se "një poezi duhet të jetë e përsosur, ose të mos ekzistojë fare". Besoj se kjo fjalë vlen në të njëjtën mënyrë ose bile më shumë për përkthimin. Poeti përgjigjet për veprën e tij, me gjithë rrezikun e dështimit, ndërsa përkthyesi përgjigjet jo vetëm për punën e vet, por edhe për veprën e poetit, të cilën me anë të një përkthimi të dobët mund ta shkatërrojë fare, pa shpresë për shërim. Prandaj përkthyesit, përveç aftësisë së nevojshme profesionale, i kanë hije edhe modestia, korrektësia, respekti absolut për veprën dhe besnikëria ndaj autorit.

Premtoj që edhe në të ardhmen do të përpiqem t'i zbatoj parimet përkatëse. Gjithashtu premtoj se do të përdor vlerën financiare e çmimit vetëm në dobi të letërsisë shqiptare.

Edhe një herë: Faleminderit!